VENDIM
Nr. 36, datë 10.4.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "WONDER" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "g", neneve 8; 9; 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Wonder" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Wonder" sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Wonder" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5–vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani